



2015/216

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

02013/028

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/2008 nenit 51, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, dhe nenit 2.1.3 dhe nenit 6.1 të Marrëveshjes së bashkëpunimit për realizimin e projektit: Përkrahje për më të varfëritë në Komunën e Vitisë nr.262 të datës 15.09.2015 e lidhur në mes Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Fondacionit Kosovo – Luxembourg dhe Komunës së Vitisë, Kryetari i Komunës së Vitisë bien këtë:

VENDIM

PËR TRANSFERIN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 10.000,00 € NË EMËR TË BASHKËFINANCIMIT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT

I

Me këtë vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë LEJON transferimin e mjeteve financiare në shumë prej 10.000,00€ (me fjalë dhjetë mijë euro) Fondacionit Kosovo – Luxembourg për realizimin e projektit- "Përkrahje për më të varfëritë në Komunën e Vitisë" duke u bazuar në nenin 2.1.3 dhe nenit 6.1 të Marrëveshjes së bashkëpunimit për realizimin e projektit: "Përkrahje për më të varfëritë në Komunën e Vitisë" nr.262 të datës 15.09.2015 e lidhur në mes Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Fondacionit Kosovo – Luxembourg dhe Komunës së Vitisë.

II.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi sigurohen nga buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2016 nga Subvendicionet e Zyrës së Kryetarit.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi derdhen në xhirollogari të Fondacionit Kosovo-Luxembourg.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e thesarit e Komunës së Vitisë.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

02. Nr. 013/
Viti, më 19.05.2016

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol Haliti

